

**VENDIM**

Nr. 335, datë 4.5.2016

**PËR TRANSFERIMIN E 100% TË
AKSIONEVE TË SHOQËRIVE
AKSIONARE “REZIDENCA
STUDENTORE NR. 1” SHA, TIRANË,
“TRAJTIMI I STUDENTËVE NR. 2” SHA,
TIRANË DHE “TRAJTIMI I
STUDENTËVE NR. 3” SHA, TIRANË,
NGA MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES TE BASHKIA
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, të neneve 3 e 4, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e 100% të aksioneve të shoqërive aksionare “Rezidenca studentore nr. 1” sh.a., Tiranë, “Trajtimi i studentëve nr. 2” sh.a., Tiranë, dhe “Trajtimi i studentëve nr. 3” sh.a., Tiranë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes te Bashkia Tiranë, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM

Nr. 336, datë 4.5.2016

**PËR TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TË
SHOQËRIVE TË TREGJEVE TË
TREGTIMIT ME SHUMICË DHE
PAKICË TË FRUTA-PERIMEVE TE
NJËSITË E VETËQEVERISJES
VENDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, pika 1.2, shkronja “a”, dhe 28, pika 2, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe të neneve 3 e 4, të ligjit 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e plotë të aksioneve të shoqërive shtetërore të tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë të fruta-perimeve në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore, sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të hartojë dokumentacionin e duhur të ndryshimit të akteve të themelimit të shoqërive që do të transferohen tek organet e vetëqeverisjes vendore dhe ta depozitojë për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

3. Shoqëritë e tregjeve, që do të transferohen, të mbartin gjendjen e pasurisë së kapitalizuar, përfshirë elementet e aktivitetit dhe pasivitetit që figurojnë në bilancet e tyre. Ajo mbart të gjitha detyrimet kreditore dhe debitorë të pasqyruara në bilanc.

4. Organet e vetëqeverisjes vendore, me zotërimin e pronësisë së aksioneve të shoqërive të tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë të fruta-perimeve, të zbatojnë dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

5. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Punëve të Brendshme, Qendra Kombëtare e Biznesit, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilave u



transferohen aksionet e shoqërive të tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë të fruta-perimeve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja 1

LISTA E SHOQËRIVE TË TREGJEVE AGROUSHQIMORE, AKSIONET E TË CILAVE DO TË TRANSFEROHEN NGA MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES NË NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

Nr.	Emërtimi i shoqërisë	Statusi	Emri i njësisë së qeverisjes vendore	% e aksioneve
1	Tregu i shitjes me shumicë, fruta-perime Vlorë	SHA	Bashkia Vlorë	100 %
2	Tregu i shitjes me shumicë, fruta-perime Shkodër	SHA	Bashkia Shkodër	67.21%
3	Tregu i shitjes me shumicë, fruta-perime Berat	SHA	Bashkia Berat	100%
4	Tregu i shitjes me shumicë dhe pakicë, fruta perime-Kukës	SHA	Bashkia Kukës	100%

VENDIM

Nr. 338, datë 4.5.2016

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA ALBAFILM SHA TE MINISTRIA E KULTURËS, TË OBJEKTIT “ISH-LABORATORI I FILMIT”, NË ZONËN KADASTRALE 8130, DHE PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10, 13, 15 e 16, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Kulturës dhe ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Albafilm sh.a. te Ministria e

Kulturës, të objektit “Ish-laboratori i filmit”, në zonën kadastrale 8130, me sipërfaqe të përgjithshme 4 918 (katër mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë) m², nga të cilat 1 420 (një mijë e katërqind e njëzet) m² sipërfaqe objekti dhe 3 498 (tre mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) m² sipërfaqe funksionale, sipas genplanit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për t’u përdorur për nevoja të Ministrisë së Kulturës.

2. Vendimi nr. 1445, datë 29.10.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënien me qira, pa konkurrim, “Top Channel” sh.a., të objektit “Ish-laboratori i filmit”, në pronësi të Albafilm sh.a., Tiranë”, revokohet.

3. Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2016, i shtohet fondi prej 38 725 768 (tridhjetë e tetë milionë e shtatëqind e njëzet e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekësh, për rregullimin e pasojave nga zgjidhja e kontratës së qirasë me subjektin “Top Channel” sh.a.

Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Agjencia e Inventarizimit dhe